



PLANI I KOMUNIKIMIT PËR GJYKATAT 2022-2024

Vizioni

**DREJTËSIA NË SHQIPËRI DO TË ARRIHET KUR TË GJITHË QYTETARËT
JANË TË SIGURT SE ATA DO TË TRAJTOHEN NË MËNYRË TË DREJTË
DHE TË BARABARTË NË BAZË TË LIGJIT, NGA NJË SISTEM GJYQËSOR
QË ËSHTË I PAVARUR , ETIK DHE EFIKAS.**

Misioni

Misioni i KLGJ është të ndërtojë, udhëheqë, dhe qeverisë një gjyqësor me performancë të lartë, që synon ekselencën dhe meriton besimin e publikut.

PËRMBAJTJA

HYRJE	4
QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT	5
PLANI I KOMUNIKIMIT	6
ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI	25

SHKURTIME

AKLGJMP	Anëtari i KLGJ-së për Marrëdhëniet me Publikun
CEPEJ	Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë
GJKKO	Gjykata për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
GJL	Gjykata e Lartë
GJM	Gjyqtari i Medias
ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
IT	Teknologjia Informacionit
JP	Juridiksion i Përgjithshëm
KLJG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
NMMP	Nëpunës për Marrëdhëniet me Median dhe Publikun (NMMP) në gjykata
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile

HYRJE

Qëllimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor është të arrijë që të gjithë aktorët institucional, media, shoqëria civile dhe qytetarët të kenë akses në sistemin gjyqësor, të përfitojnë nga shërbimet e shumta që ofrohen dhe të kenë besim se ky sistem është i pavarur, i paanshëm dhe garanton sundimin e së drejtës dhe i shërben interesit publik. Plani i komunikimit dy-vjeçar të gjykatave është një pikënisje për të strukturuar mënyrën sesi ato i përfaqes publikut dhe aktorëve të tjerë të interesit gjatë një procesi komunikimi e ndërveprimi dhe ka si qëllim të mbështesë zbatimin e Planit Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor.

Plani i Komunikimit shoqërohet me një Plan Veprimi duke dhënë ide dhe mjete praktike për ta bërë komunikimin më të lehtë, më të kuptueshëm dhe me sa më shumë ndikim në drejtim të rritjes së transparencës, nivelit të informimit, cilësisë së shërbimeve, profesionalizmit dhe për rrjedhojë, besimit të publikut në sistemin gjyqësor. Ai përcakton përparësitë e komunikimit, objektivat, grupet e synuara, mesazhet kryesore dhe mjetet e nevojshme të komunikimit

Plani i komunikimit ofron zgjidhje novatore dhe qasjet më të mira për të komunikuar në mënyrë efektive duke shfrytëzuar të gjithë mjetet e komunikimit që mundëson teknologjia. Ai do të përditësohet në mënyrë të vazhdueshme në varësi të zhvillimeve për t'u përshtatur me situata apo prioritete që mund të paraqiten në të ardhmen dhe i takon të gjithë aktorëve që ta jetësojnë atë.

QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Qëllimi i Planit të Komunikimit është të përcaktojë mënyrat dhe mjetet e nevojshme të komunikimit, objektivat, audiencat dhe mesazhet kryesore, gjatë një harku kohor 2 vjeçar (2022 – 2024), në mënyrë që të rritet niveli i aksesit në informacion që publiku dhe media duhet të kenë mbi gjykatat, në funksion të rritjes së besimit të publikut në veprimtarinë e tij.

Plani i komunikimit të gjykatave është rrjedhojë e **Planit Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor**, e në këtë kuptim, qëllimi dhe objektivat e këtij plani janë në përputhje me synimet dhe objektivat strategjike që Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar për sistemin gjyqësor.

Qëllimi kryesor - Rritja e besimit të publikut dhe e transparencës në sistemin gjyqësor nëpërmjet përdorimit të mjeteve dhe mënyrave novatore të komunikimit dhe informimit midis gjykatës me median dhe publikun.

Në mënyrë që qëllimi kryesor të arrihet, gjashtë objektiva kryesorë strategjikë janë parashikuar:

Objektivi nr.1: Informimi i publikut dhe promovimi i rezultateve të arritura deri më sot për sistemin gjyqësor nga zbatimi i Reformës në Drejtësi;

Objektivi Nr. 2: Identifikimi, promovimi, informimi dhe rritja e transparencës së sistemit gjyqësor nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit, si mjet novator i komunikimit në mënyrë efikase dhe të shpejt, mes grupeve të interesit dhe gjykatave;

Objektivi Nr.3: Informimi i publikut me një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, mbi funksionet, veprimtarinë e gjykatave dhe mënyrën se si mund t'i drejtohen gjykatës;

Objektivi Nr.4: Informimi i publikut, veçanërisht i grupeve në nevojë dhe të miturve, lidhur me ndihmën juridike të garantuar nga shteti dhe tarifatat gjyqësore;

Objektivi Nr:5: Forcimi i komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet gjykatave dhe medias, OShC-ve, palëve të tjera të interesit;

Objektivi Nr: 6 Afrimi i komunitetit me Gjykatat përmes organizimit të aktiviteteve publike dhe fushatave ndërgjegjësuese që kulmojnë në Javën e Drejtësisë.

PLANI I KOMUNIKIMIT

QËLLIMI

RRITJA E BESIMIT TË PUBLIKUT DHE E TRANSPARENCËS NË SISTEMIN GJYQËSOR NËPËRMJET PËRDORIMIT TË MJETEVE DHE MËNYRAVE NOVATORE TË KOMUNIKIMIT DHE INFORMIMIT MIDIS GJYKATËS ME MEDIAN DHE PUBLIKUN.

Sistemi gjyqësor përjetoi një proces transformues në kuadër të Reformës në Drejtësi dhe ende ka nevojë për informimin e publikut mbi ndryshimet që e prekin drejtpërdrejtë, rezultatet por edhe sfidat dhe problematikat me të cilat ky proces është shoqëruar. Besimi i publikut krijohet përmes rritjes së njohurive, ndaj ky plan synon fillimisht të informojë publikun në mënyrë që ky i fundit të krijojë qëndrime të bazuara në informacion dhe jo në perceptime.

MESAZHI KRYESOR

Një sistem gjyqësor që funksionon mbi parimin e pavarësisë, paanshmërisë, profesionalizmit, transparencës dhe të barazisë së individëve para ligjit, meriton besimin e publikut!

Objektivi nr.1: Informimi i publikut dhe promovimi i rezultateve të arritura deri më sot për sistemin gjyqësor nga zbatimi i Reformës në Drejtësi.

Ky objektivi do të fokusohet në ofrimin e informacionit mbi:

- Rëndësinë dhe ndikimin e reformës në drejtësi në sistemin gjyqësor;
- Riorganizimin e kompetencave tokësore të gjykatave;
- Ndryshimet ligjore, si risitë në procedurën civile e penale, ndryshimi i tarifave gjyqësore apo ndryshime të tjera ligjore që prekin drejtpërdrejt qytetarët/ publikun.

Grupet e Synuara	Institucionet Përgjegjëse	Stafi Përgjegjës	Kanalet e Komunikimit
<ul style="list-style-type: none">•Qytetarët;•Përdoruesit e gjykatës;•Media	<ul style="list-style-type: none">•KLGJ•Gjykatat	<ul style="list-style-type: none">•Anëtari i KLGJ për MPM•Gjyqtari i Medias•NMPM•Kryetari•Kancelari	<ul style="list-style-type: none">•TV/Radio;•Faqe Interneti•Rrjete Sociale•Aktivitete

Në mënyrë që ky objektivi të përmbushet, gjykatat duhet të kryejnë veprimet e mëposhtme:

Veprimi 1.1: Hartimi dhe publikimi i materialeve informuese në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme lidhur me riorganizimin e kompetencave tokësore të gjykatave.

	Publikimi <i>online</i> i grafikës informuese për secilën gjykatë, që përmban shpjegimin mbi kompetencën tokësore, numrin e gjyqtarëve, infrastrukturën, largësinë, etj.;
	Publikimi i një materiali informues <i>online</i> , në gjuhë të thjeshtë mbi riorganizimin gjyqësor në tërësi;
Hapat konkretë	Publikimi i një video informuese mbi riorganizimin e gjyqësorit, duke e shoqëruar me audio dhe gjuhën e shenjave;
	Publikimi në faqen e internetit dhe rrjetet sociale të KLGJ, gjykatave dhe grupeve të interesit si dhe bashkëpunimi me median;
	Matja e numrit të shikimeve, pëlqimeve, shpërndarjeve, komenteve etj.

Veprimi 1.2: Hartimi dhe publikimi i materialeve informuese në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme lidhur me organizimin dhe funksionimin e gjykatave dhe rezultatet e arritura.

	Publikimi i një materiali informues në rrjet, në gjuhë të thjeshtë mbi organizimin, funksionimin dhe kompetencat gjykatave dhe në veçanti mbi gjykatat e posaçme;
	Publikimi i një video informuese mbi organizimin, funksionimin dhe kompetencat e gjykatave të posaçme duke e shoqëruar me audio dhe gjuhën e shenjave;
Hapat konkretë	Publikimi <i>online</i> i grafikës informuese që përmban informacion dhe shifra lidhur me rezultatet kryesore të punës së gjykatave, çdo vit;
	Publikimi i materialeve <i>online</i> duke përfshirë faqet e internetit dhe rrjetet sociale të KLGJ, gjykatave, grupeve të interesit si dhe publikimi në media;
	Matja e numrit të shikimeve, pëlqimeve, shpërndaje, komente etj.

Veprimi 1.3: Intervista në media me qëllim informimin mbi ndryshimet/risitë/përfitimet që solli Reforma në Drejtësi dhe promovimi i rezultateve të arritura.

	Dhënia e intervistave televizive në median kombëtare ose lokale për secilën gjykatë të çdo niveli;
Hapat konkretë	Dhënia e intervistave televizive në median kombëtare mbi organizimin, funksionimin, kompetencat e posaçme dhe rezultatet e punës së gjykatave të juridiksionit të posaçëm;
	Publikimi i tyre në faqen e internetit dhe rrjetet sociale.

MESAZHET MBËSHTETËSE PËR OBJEKTIVIN I

Sistemi i Drejtësisë është reformuar! Tashmë kemi një arkitekturë të re të sistemit të drejtësisë dhe një rikonfigurim të shpërndarjes gjeografike të gjykatave në rang vendi, duke synuar shërbime efikase dhe në kohë të arsyeshme.

Reforma në Drejtësi ka sjellë një ndryshim rrënjësor në marrëdhënien e gjykatave me publikun dhe median duke garantuar transparencë dhe përgjegjshmëri.

Indikatorët e përmbushjes së Objektivit I

1. Numri i materialeve informuese mbi rezultatet e Reformës në Drejtësi dhe ndikimin e saj në sistemin gjyqësor;
2. Numri i individëve të informuar dhe ndërgjegjësuar të cilët shikojnë/pëlqejnë, komentojnë apo ndajnë materialet informuese;
3. Numri i intervistave në mediet publike për të promovuar rezultatet e deritanishme të Reformës;

Njësitë Matëse:

- ✓ Një ose më shumë infografik/a për gjykatë;
- ✓ Një ose më shumë material/e informues/e *online* për gjykatë;
- ✓ Një ose më shumë video informuese për gjykatë;
- ✓ Një ose më shumë video/intervistë/a për gjykatë;
- ✓ 10 % më shumë individë të informuar çdo muaj;

Objektivi nr.2: Identifikimi, promovimi, informimi dhe rritja e transparencës së sistemit gjyqësor nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit, si mjet novator i komunikimit në mënyrë efikase dhe të shpejt, mes grupeve të interesit dhe gjykatave.

Epoka dixhitale shton nevojën e gjykatave për të identifikuar dhe promovuar sistemet e teknologjisë së informacionit përmes të cilave komunikojnë me publikun, palët e interesuara dhe median. Tashmë forma tradicionale e komunikimit të gjykatave duhet t'i përshtatet kërkesave të publikut dhe nevojave të tyre për një komunikim interaktiv, të shpejtë, efikas dhe cilësor.

Për këtë qëllim, ky objektivi do të përqendrohet në:

- Pasurimin e faqeve të internetit me informacione të përmbledhura dhe në një gjuhë të kuptueshme, mbi mënyrën se si mund t'i drejtohen gjykatës për të nisur një proces gjyqësor, aksesin në gjykatë nga kategoritë e veçanta dhe grupet vulnerabël, ndihmën juridike falas, etj;
- Informimin mbi përdorimin, mënyrën e kërkimit dhe marrjes së informacionit dhe promovimin e faqeve të internetit të gjykatave;
- Përdorimin nga ana e gjykatave, të rrjeteve sociale për të informuar publikun mbi veprimtarinë e tyre;
- Përditësimin e rrjeteve sociale dhe faqeve të internetit me informacione në lidhje me ndryshimin e mundshëm të orarit, sallave, vendndodhjes, procedurave, apo informacioneve të tjera me rëndësi për publikun si dhe promovimin e përdorimit të tyre.

Grupet e Synuara	Institucionet Përgjegjëse	Stafi Përgjegjës	Kanalet e Komunikimit
<ul style="list-style-type: none">• Qytetarët;• Përdoruesit e gjykatës;• Media	<ul style="list-style-type: none">• KLGJ• Gjykatat	<ul style="list-style-type: none">• Anëtari i KLGJ për MPM• Gjyqtari i Medias<ul style="list-style-type: none">• NMPM• Kryetari• Kancelari	<ul style="list-style-type: none">• TV/Radio;• Faqe Interneti• Rrjete Sociale• Aktivitete

Në mënyrë që ky objektivi të përmbushet, gjykatat duhet të kryejnë veprimet e mëposhtme:

Veprimi 2.1 Krijimi, plotësimi ose përditësimi i llogarive në rrjete sociale, *Facebook*, *LinkedIN* dhe *Twitter* për secilën Gjykatë.

Hapat konkretë	Krijimi, plotësimi dhe/ose përditësimi i llogarive në FB, LinkedIN dhe Twitter për secilën gjykatë;
	Përditësimi periodik i llogarive.

Veprimi 2.2 Hartimi i media-planeve për publikimet në rrjetet sociale të Gjykatave.

Hapat konkretë	Hartimi i formatit të media-planit;
	Hartimi i media-planeve nga secila gjykatë;
	Zbatimi i media-planeve nga secila gjykatë.

Veprimi 2.3 Krijimi dhe/ose përditësimi i rubrikave të veçanta në faqen www.gjykata.gov.al dedikuar publikimit të informacioneve për qytetarët.

Hapat konkretë	Krijimi dhe/ose përditësimi i rubrikave të dedikuara nga secila gjykatë;
	Krijimi dhe/ose përditësimi i rubrikës “Pyetje të shpeshta” (FAQ) ;
	Publikimi i materialeve informuese në rubrikë.

Veprimi 2.4 Video shpjeguese dhe udhëzues mbi mënyrën e kërkimit dhe marrjes së informacionit në faqen www.gjykata.gov.al;

	Krijimi i videove shpjeguese (<i>tutorial video</i>) sipas specifikave të faqeve të internetit të secilës gjykatë;
Hapat konkretë	Udhëzues i hartuar dhe printuar për gjykatë;
	Publikimi në faqen e internetit dhe rrjetet sociale të KLGJ, gjykatave dhe grupeve të interesit.

Veprimi 2.5 Promovimi i faqes së internetit të Gjykatave dhe rrjeteve sociale të Gjykatave.

	Publikimi i posterave për të promovuar faqe e internetit dhe rrjetet sociale të Gjykatave;
Hapat konkretë	Printimi i posterave me kode <i>QR</i> nga secila gjykatë dhe përmbajnë informacion mbi faqen e internetit/rrjeteve sociale të Gjykatës;
	Vendosja e posterave në institucione me frekuentim të gjerë nga qytetarët.

Veprimi 2.6 Publikimi i gazetës elektronike në të cilën do të trajtohen çështje që lidhen me veprimtarinë e Gjykatës së Lartë, ndryshimet në legjislacion, vendime unifikuese, statistika etj.

	Përditësimi dhe publikimi i gazetës online çdo tre muaj;
Hapat konkretë	Shpërndarja e gazetës në grupet e interesit.

MESAZHET MBËSHTETËSE PËR OBJEKTIVIN II

Sistemi gjyqësor është i përkushtuar për të garantuar transparencë dhe informim të publikut përmes përdorimit të platformave të reja të komunikimit të cilat mundësojnë informacion të shpejtë dhe akses në çdo kohë për të gjithë qytetarët.

Komunikim efikas dhe i shpejtë mes palëve të interesit dhe gjykatave për të garantuar transparencë në veprimtarinë e gjykatave dhe informimin e publikut.

Indikatorët e përmbushjes së Objektivit II

1. Numri i media –planeve për rrjetet sociale;
2. Numri i videove shpjeguese dhe udhëzuesve mbi mënyrën e kërkimit dhe marrjes së informacionit në faqen/et e internetit të Gjykatave;
3. Numri i posterave për të promovuar faqet e internetit dhe rrjetet social të gjykatave.
4. Numri i gazetave elektronike të publikuara nga Gjykatës së Lartë.

Njësitë Matëse:

- ✓ 20 media–plane të hartuara;
- ✓ të paktën një video shpjeguese e krijuar për faqen e internetit dhe një udhëzues i printuar për gjykatë në 1000 kopje;
- ✓ të paktën 100 postera me kode QR të printuara nga secila gjykatë;
- ✓ të paktën 8 gazeta elektronike (Gj.L).

Objektivi nr.3: Informimi i publikut me një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, mbi funksionet, veprimtarinë e gjykatave dhe mënyrën se si mund t'i drejtohen gjykatës.

Krahas përdorimit të mjeteve të përshtatshme të teknologjisë së informacionit, gjykatat duhet të garantojnë një informim cilësor të publikut që do t'i shërbejë këtij të fundit për të plotësuar nevojat. Informimi cilësor nënkupton që gjykatat ofrojnë informacion, në një gjuhë të thjeshtë dhe lehtësisht të kuptueshme, të vlefshëm dhe të saktë për publikun, duke shmangur terminologjinë teknike e cila shton konfuzionin.

Në këtë kuptim ky objektivi do të synojë:

- Përdorimin e materialeve informuese, mediave sociale dhe mediave televizive për të rritur informimin dhe njohuritë e qytetarëve në lidhje me veprimtarinë e gjykatave të secilit nivel;
- Informimin mbi paraqitjen e një çështje civile;
- Informimin mbi procedurën që ndiqet në çështjet penale nga faza e arrestimit deri në gjykim;
- Informimin mbi paraqitjen e një çështje administrative;
- Ofrimin e informacioneve në lidhje me procedurat e depozitimit dhe shqyrtimit të kërkesave nga gjykatat;
- Ofrimin e informacionit mbi plotësimin dhe depozitimin e formularëve online;
- Ofrimin e informacionit mbi afatet dhe mënyrën e ushtrimit të të drejtës së ankimit/rekursit.

Grupet e Synuara	Institucionet Përgjegjëse	Stafi Përgjegjës	Kanalet e Komunikimit
<ul style="list-style-type: none">•Qytetarët;•Përdoruesit e gjykatës;•Media	<ul style="list-style-type: none">•KLGJ•Gjykatat	<ul style="list-style-type: none">•Anëtari i KLGJ për MPM•Gjyqtari i Medias<ul style="list-style-type: none">•NMPM•Kryetari•Kancelari	<ul style="list-style-type: none">•TV/Radio;•Faqe Interneti•Rrjete Sociale•Aktivitete

Në mënyrë që ky objektivi të përmbushet, gjykatat duhet të kryejnë veprimet e mëposhtme:

Veprimi 3.1 Hartimi i materialeve informuese mbi procedurën që ndiqet në çështjet penale, civile dhe ato administrative; mënyrën e paraqitjes së çështjeve, kërkesave/ankesave drejtuar gjykatës; formatet standarde; mjetet alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve (ndërmjetësimi); shërbimet që mund të merren nga Gjykata; e drejta e ankimit/rekursit dhe afatet.

	Hartimi i tre broshurave <i>online</i> (penale, civile dhe procedura administrative) të përshtatura për secilën gjykatë;
	Përgatitja dhe publikimi online i fletëpalosjeve mbi kërkesat/ankesat drejtuar gjykatës;
	Publikimi në faqen e internetit të formateve standarde të akteve dhe kërkesave që i drejtohen gjykatës;
Hapat konkretë	Përgatitja dhe publikimi i një fletëpalosje dhe një video <i>online</i> për ndërmjetësimin; si dhe fletëpalosje të printuara në total për gjykatat e rretheve gjyqësore 2000 koje në vit;
	Përgatitja dhe publikimi online i një fletëpalosje dhe një video për shërbimet e ofruara;
	Përgatitja dhe publikimi online i dy fletëpalosje mbi të drejtën e ankimit dhe rekursit;
	Publikimi në faqen e internetit dhe rrjetet sociale të materialeve të përgatitura nga secila gjykatë.

Veprimi 3.2 Realizimi i një video “Turi virtual i gjykatës” duke paraqitur gjykatën dhe ambientet e saj (sportelet, sallat e gjyqit, siguria, kodin e sjelljes, infrastrukturën për PAK, etj.)

	Përgatitja e një videoje për secilën gjykatë duke e shoqëruar me audio dhe gjuhën e shenjave;
Hapat konkretë	Publikimi në faqen e internetit dhe rrjetet sociale.

MESAZHET MBËSHTETËSE PËR OBJEKTIVIN III

Të njihemi me gjykatat dhe procedurat gjyqësore! Gjykatat garantojnë informim cilësor dhe në kohë të publikut përmes ofrimit të informacioneve të thjeshta, praktike dhe të përditësuara mbi veprimtarinë e tyre, shërbimet dhe procedurat gjyqësore.

Publiku ka të drejtë të informohet nëpërmjet çdo kanali komunikimi që gjykatat disponojnë, mbi të drejtat e tyre, afatet ligjore, procedurat dhe dokumentacionet përkatëse, si dhe çdo informacion tjetër lidhur me garancitë e tyre ligjore.

Indikatorët e përmbushjes së Objektivit III

1. Numri i materialeve informuese mbi procedurat gjyqësore, ankesat/kërkesat, ankimet, afatet ligjore dhe shërbimet gjyqësore për palët në proces dhe ato të interesuara;
2. Numri i materialeve informuese lidhur me mjetet alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve;
3. Numri i videove prezantuese të gjykatës.

Njësitë Matëse:

- ✓ 3 broshura dhe video mbi procedurat gjyqësore civile, penale dhe administrative për secilën gjykatë;
- ✓ 1 material informues online mbi kërkesat/ankesat drejtuar gjykatës dhe formatet standarde për secilën gjykatë;
- ✓ 1 fletëpalosje online mbi të drejtën e ankimit/ rekursit për secilën gjykatë;
- ✓ 1 video mbi shërbimet e ofruara për secilën gjykatë;
- ✓ 1 video për PAK për hapat në të cilat kalon një çështje në gjykatë;
- ✓ të paktën 1 fletëpalosje dhe 1 video online për ndërmjetësimin;
- ✓ 1 video “Turi virtual i gjykatës” për secilën gjykatë prodhuar dhe publikuar në faqen e internetit dhe rrjetet sociale.

Objektivi nr.4: Informimi i publikut, veçanërisht i grupeve në nevojë dhe të miturve, lidhur me ndihmën juridike të garantuar nga shteti dhe tarifën gjyqësore.

Hartimi i këtij Plani Komunikimi vjen i përshtatur me nevojat e të gjitha grupeve të interesit, e sidomos të atyre në nevojë, gjendja ekonomiko-sociale e të cilëve e bën akoma edhe më të rëndësishme nevojën për informim mbi shërbimet publike që ofrojnë gjykatat. Në këtë perspektivë, ky objektivi do të fokusohet në:

- Informimin e kategorive të veçanta dhe grupeve në nevojë mbi ndihmën juridike falas;
- Ofrimin e informacionit mbi përfitimin nga ndihma juridike detyruese;
- Ofrimin e informacionit mbi tarifën gjyqësore dhe kategoritë e përjashtuara nga pagesa e tarifës gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore;
- Informacion mbi drejtësinë penale për të mitur.

Grupet e Synuara	Institucionet Përgjegjëse	Stafi Përgjegjës	Kanalet e Komunikimit
<ul style="list-style-type: none">• Qytetarët;• Përdoruesit e gjykatës;• Media	<ul style="list-style-type: none">• KLGJ• Gjykatat	<ul style="list-style-type: none">• Anëtari i KLGJ për MPM• Gjyqtari i Medias• NMPM• Kryetari• Kancelari	<ul style="list-style-type: none">• TV/Radio;• Faqe Interneti• Rrjete Sociale• Aktivitete

Në mënyrë që ky objektivi të përmbushet, gjykatat duhet të kryejnë veprimet e mëposhtme:

Veprimi 4.1 Hartimi dhe publikimi i materialeve informuese mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti.

Hartimi dhe publikimi i materialit informues mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti, online dhe i printuar;

Hapat
konkretë

Përgatitja dhe publikimi i videos së animuar dhe me zë “Ndihma juridike falas - kush dhe si e përfiton?”.

Veprimi 4.2 Hartimi dhe publikimi i materialeve informuese mbi tarifatat gjyqësore.

	Hartimi dhe publikimi i materialit informues, online dhe i printuar mbi tarifatat gjyqësore;
Hapat konkretë	Përgatitja dhe publikimi i videos së animuar dhe me zë “Kush përjashtohet nga pagesa e tarifës dhe shpenzimeve gjyqësore?”.

Veprimi 4.3 Përgatitja e materialeve informuese mbi të drejtat e të miturve në konflikt me ligjin gjatë procesit penal dhe të drejtat e të miturve viktimë ose dëshmitarë të veprës penale.

	Hartimi dhe publikimi i fletëpalosjes dhe videos online për të drejtat e të miturit në konflikt me ligjin;
Hapat konkretë	Hartimi dhe publikimi i fletëpalosjes dhe videos online për të drejtat e të miturit viktimë ose dëshmitar i veprës penale”.

Veprimi 4.4 Pjesëmarrja në median kombëtare ose lokale të përfaqësuesve të Gjykatave me qëllim informimin mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti dhe tarifatat gjyqësore.

Hapat konkretë	Dhënia e intervistave në media kombëtare ose lokale.
----------------	--

MESAZHET MBËSHTETËSE PËR OBJEKTIVIN IV

Grupet në nevojë kanë akses në gjykata dhe në shërbimet që ofrojnë ato duke përfituar kështu drejtësi efektive njëlloj si çdokush tjetër!

Të gjithë individët, pjesë e grupeve vulnerabël dhe/ose me të ardhura të pamjaftueshme që nuk kanë mundësi t’i drejtohen një avokati për të zgjidhur problematikën e tyre ligjore, përfitojnë ndihmë ligjore falas, të garantuar nga shteti.

Indikatorët e përmbushjes së Objektivit IV

1. Numri i materialeve informuese mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti;
2. Numri i materialeve informuese mbi tarifatat gjyqësore;
3. Numri i materialeve informuese mbi të drejtat e të miturve në konflikt me ligjin gjatë procesin penal dhe të drejtat e të miturve viktimë ose dëshmitarë të veprës penale;
4. Numri i intervistave publike informuese mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti dhe tarifatat gjyqësore.

Njësitë Matëse:

- ✓ *1 material informues mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti, printuar në të paktën 1000 kopje për gjykatë,*
- ✓ *1 video e animuar “Ndihma juridike falas”;*
- ✓ *1 material informues për tarifatat gjyqësore i printuar në të paktën 1000 kopje për Gjykatë;*
- ✓ *1 video mbi tarifatat gjyqësore;*
- ✓ *2 fletëpalosje dhe 2 video online për të drejtat e të miturit në konflikt me ligjin/ viktimë ose dëshmitarë të veprës penale;*
- ✓ *të paktën 1 intervistë për gjykatë;*
- ✓ *Publikimi i materialeve informuese në faqen e internetit dhe në rrjetet sociale të gjykatave.*

Objektivi nr.5: Forcimi i komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet gjykatave dhe medias, OSHC-ve, palëve të tjera të interesit.

Nisur nga rëndësia që kanë media, OSHC-të apo grupet e tjera të interesit në përcjelljen e informacionit dhe komunikimin me publikun, Plani i Komunikimit synon rritjen e bashkëpunimit dhe fuqizimin e komunikimit me këta aktorë. Ky komunikim dhe bashkëpunim do t'i shërbejë publikut të gjerë, ndaj, krahas nevojës për të komunikuar me këta aktorë, gjykatat duhet t'i shohin këta të fundit në funksion të shumëfishimit të përpjekjeve të tyre për të komunikuar me publikun.

Ky objektivi do të vijë i materializuar përmes:

- Forcimit të koordinimit dhe komunikimit midis gjykatave me median duke zhvilluar takime të përbashkëta për të lehtësuar informimin në mënyrë korrekte dhe të shpejtë të qytetarëve;
- Komunikimit i vendimeve gjyqësore për çështje që kanë interes të veçantë publik, përmes NMMP-ve dhe mediave;
- Zhvillimit të takimeve informuese periodike me përfaqësues të medias dhe OSHC-ve për të rritur informimin e tyre mbi procedurat e marrjes së informacionit, mbrojtjes së të dhënave personale dhe konfidenciale etj.;
- Zhvillimit të intervistave televizive të NMMP-ve dhe gjyqtarëve për median për të promovuar veprimtarinë e gjykatave;
- Bashkëpunimit dhe zhvillimit të takimeve të përbashkëta me OSHC-të dhe palët e tjera të interesit.

Grupet e Synuara	Institucionet Përgjegjëse	Stafi Përgjegjës	Kanalet e Komunikimit
<ul style="list-style-type: none">•Qytetarët;•Përdoruesit e gjykatës;•Media•PAK•Të miturit•OSHC-të•Grupet në nevojë	<ul style="list-style-type: none">•KLGJ•Gjykatat	<ul style="list-style-type: none">•Anëtari i KLGJ për MPM•Gjyqtari i Medias•NMMP•Kryetari•Kancelari	<ul style="list-style-type: none">•TV/Radio;•Faqe Interneti•Rrjete Sociale•Aktivitete

Në mënyrë që ky objektivi të përmbushet, gjykatat duhet të kryejnë veprimet e mëposhtme:

Veprimi 5.1 Tryezë diskutimi me OSHC-të dhe grupet e interesit me qëllim forcimin e bashkëpunimit.

Mbajtja e një tryeze diskutimi me OSHC-të dhe grupet e interesit;

Hapat
konkretë

Bashkëpunimi ndërmjet KLGJ/Gjykata me OSHC dhe grupet e tjera të interesit për përgatitjen e materialeve të tjera informuese.

Veprimi 5.2 Aktivitete informuese dhe ndërgjegjësuere në bashkëpunim me OSHC-të.

Hapat
konkretë

Zhvillimi i aktiviteteve informuese me qytetarë, grupe në nevojë, nxënës/të rinj, gra/vajza, etj. të organizuara në bashkëpunim me OSHC-të mbi tematika me interes për publikun (psh: ndihma juridike e garantuar nga shteti, tarifatat gjyqësore, dhuna në familje, urdhrat e mbrojtjes, çështje të pronësisë, drejtësia penale për të mitur, etj.)

Veprimi 5.3 Aktivitete informuese dhe ndërgjegjësuere në bashkëpunim me Fakultetet e Drejtësisë.

Hapat
konkretë

Zhvillimi i aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere me studentë të Fakulteteve të Drejtësisë (gjyqë imituese) që trajtojnë tematika me interes për qytetarët.

Veprimi 5.4 Aktivitete informuese me median dhe studentët e gazetarisë (Reforma në Drejtësi dhe ecuria e saj, riorganizimi gjyqësor, ndryshimet ligjore që prekin drejtpërdrejt qytetarët, roli i medias ne edukimin ligjor të qytetarëve, etj).

Zhvillimi i takimeve me gazetarët që mbulojnë fushën e drejtësisë;

Hapat
konkretë

Zhvillimi i leksioneve të hapura në Fakultetet e Gazetarisë.

MESAZHET MBËSHTETËSE PËR OBJEKTIVIN V

Rritja e transparencës së sistemit gjyqësor, ofrimi i shërbimeve në kohë dhe me efikasitet, edukimi i qytetarëve për sundimin e ligjit dhe sistemin e drejtësisë mbështeten tek ndërveprimi i gjykatave me publikun. Të gjithë së bashku do të rikthejmë besimin e qytetarëve në sistemin gjyqësor.

Indikatorët e përmbushjes së Objektivit V

1. Numri i aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere me OSHC-të;
2. Numri i aktiviteteve në bashkëpunim me Fakultetet e Drejtësisë;
3. Numri i aktiviteteve informuese me median dhe studentët e gazetarisë.

Njësitë Matëse:

- ✓ të paktën 1 tryezë diskutimi me OSHC-të dhe grupet e interesit për secilën gjykatë;
- ✓ të paktën 1 aktivitet për vit akademik me studentët e Fakultetit të Drejtësisë;
- ✓ Të paktën 1 aktivitet/ditë e hapur me pjesëmarrjen e qytetarëve për secilën gjykatë;
- ✓ Takime me gazetarët që mbulojnë fushën e drejtësisë (të paktën 2 takime në vit dhe të paktën 1 leksion i hapur në vit në Fakultetet e Gazetarisë).

Objektivi nr.6: Afrimi i komunitetit me Gjykatat përmes organizimit të aktiviteteve publike dhe fushatave ndërgjegjësuere që kulmojnë në Javën e Drejtësisë.

Organizimi i aktiviteteve publike që përafrojnë komunitetin me gjykatat marrin vëmendje të veçantë në këtë Plan Komunikimi. Ky objektivi ka për qëllim që eksperiencën e akumuluar ndër vite ta shndërrojë në një traditë tashmë të konsoliduar, e cila do të kulmojë me organizimin e aktiviteteve publike apo fushatave ndërgjegjësuere në kuadër të 10 Majit, Ditës Kombëtare të Drejtësisë. Aktivitetet synohen të shtrihen përgjatë gjithë javës së parë të muajit maj, duke e cilësuar këtë si “Java e Drejtësisë”.

Organizimi i këtyre aktiviteteve në mënyrë të decentralizuar nga gjykatat pranë komuniteteve respektive, por të planifikuara në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor, do t’i shërbejë afrimit të publikut me gjykatat dhe rritjes së besimit të tij në sistemin gjyqësor.

Ky objektivi do të vijë i materializuar përmes:

- Veprimeve të koordinuara të gjykatave për organizimin e Javës së Drejtësisë nën drejtimin e KLGJ;
- Bashkëpunimit me grupet e interesit;
- Përgatitjes së materialeve promovuese dhe informuese për “Javën e Drejtësisë”;
- Zhvillimit të aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere me komunitetin (ditë të hapura në gjykatë, vizita institucionale me grupe të caktuara të komunitetit në ambientet e gjykatave apo edhe KLGJ, konferencave apo tryezave të diskutimit, aktivitete të organizuara me grupet e interesit, etj).

Grupet e Synuara	Institucionet Përgjegjëse	Stafi Përgjegjës	Kanalet e Komunikimit
<ul style="list-style-type: none">• Qytetarët;• Përdoruesit e gjykatës;• Media	<ul style="list-style-type: none">• KLGJ• Gjykatat	<ul style="list-style-type: none">• Anëtari i KLGJ për MPM• Gjyqtari i Medias• NMPM• Kryetari• Kancelari	<ul style="list-style-type: none">• TV/Radio;• Faqe Interneti• Rrjete Sociale• Aktivitete

Në mënyrë që ky objektivi të përmbushet, gjykatat duhet të kryejnë veprimet e mëposhtme:

Veprimi 6.1 Organizimi i Javës së Drejtësisë dhe vendosja e bashkëpunimit me grupet e interesit.

Përgatitja e kalendarit të aktiviteteve sipas Gjykatave të paktën 3 muaj përpara Javës së Drejtësisë;

Hapat
konkretë

Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë dhe grupet e interesit (OSHC-të, universitetet, media etj) për zbatimin e kalendarit të aktiviteteve.

Veprimi 6.2 Përgatitja e materialeve promovuese për “Javën e Drejtësisë”.

Krijimi i Logos identifikuese të Javës së Drejtësisë;

Përcaktimi i Sloganit;

Printimi dhe vendosja e materialeve promovuese si postera, baner, Tshirts, stema etj, në ambientet e secilës Gjykatë;

Hapat
konkretë

Krijimi dhe përdorimi i *Hashtag*-ut (#) të "Javës së Drejtësisë" për të gjithë postimet në rrjete sociale nga KLGJ dhe gjykatat;

Krijimi dhe publikimi i videos promovuese të aktiviteteve të "Javës së Drejtësisë";

Publikimi i kalendarit të aktiviteteve në faqet e internetit dhe rrjetet sociale të gjykatave dhe afishimi në ambientet e gjykatave dhe të institucione me frekuentim të gjerë të qytetarëve.

Veprimi 6.3 Aktivitete informuese dhe ndërgjegjësuere me komunitetin (aktivitetet sipas Objektivit nr.5 mund të zhvillohen edhe gjatë Javës së Drejtësisë).

Organizimi i Ditës së Hapur në çdo Gjykatë;

Hapat
konkretë

Organizimi i konferencës/tryezës së diskutimi nga KLGJ me gjykatat dhe grupet e interesit mbi çështje aktuale apo problematika të sistemit gjyqësor.

MESAZHET MBËSHTETËSE PËR OBJEKTIVIN VI

Sjellim gjykatën me afër komunitetin! Çdo anëtar i komunitetit ka të drejtë të njihet me rolin dhe misionin e gjykatës në shoqëri. Afrimi me komunitetin përmes fushatave të mirëmenduara, planifikuara dhe organizuara, rrit nivelin e njohjes dhe informimit të publikut mbi sistemin gjyqësor.

Zvogëlimi i hendekut mes komunitetit dhe gjykatave i shërben më së miri rikthimit të besimit tek sistemi gjyqësor.

Indikatorët e përmbushjes së Objektivit VI

1. Numri i gjykatave të angazhuara në organizimin e “Javës së Drejtësisë”;
2. Numri i aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere për “Javën e Drejtësisë”;
3. Numri i materialeve informuese për “Javën e Drejtësisë” të publikuara.

Njësitë Matëse:

- ✓ *Kalendari i aktiviteteve i miratuar;*
- ✓ *Gjykatat e angazhuara në aktivitete;*
- ✓ *Materialet promovuese si video, postera, baner, Tshirts, stema etj, të krijuara, dhe të vendosura në ambientet e gjykatave, dhe të publikuara;*
- ✓ *Printimi, nga çdo Gjykatë, në 100 kopje e secilit material informues të hartuar;*
- ✓ *Të paktën 1 ditë e hapur për qytetarët organizohet në Javën e Drejtësisë në çdo gjykatë;*
- ✓ *1 konferencë/tryezë diskutimi në vit e organizuar nga KLGJ me Gjykatat dhe grupet e interesit.*

ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Suksesi i këtij Plani Komunikimi ndërvaret nga zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi i planit të tij të veprimit. Në kuadër të zbatimit dhe monitorimit, secila gjykatë do të caktojë pikën e kontaktit për këtë qëllim, i cili mund të jetë gjyqtari, nëpunësi për marrëdhënien me median dhe publikun/koordinatori i të drejtës së informimit ose çdo person tjetër i përcaktuar prej tyre me funksionet e marrëdhënies me median dhe publikun.

Pika e kontaktit do të paraqesë çdo 3 muaj, raportin e realizimit dhe ecurisë së zbatimit të Planit, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas formatit të unifikuar të raportit, shtojcë e këtij Plani. Monitorimi do të mbështetet në progresin e zbatimit të çdo aktiviteti të parashikuar në Planin e Veprimit duke ndjekur rregullisht zbatimin e aktiviteteve sipas përshkrimit, afatin e realizimit të tyre dhe përmbushjen e indikatorëve të parashikuar. Qëllimi i këtij monitorimi është adaptimi/përmirësimi i planit në varësi të kushteve, rrethanave apo nevojave që gjykatave mund t'i lindin gjatë kohës së zbatimit të tij. Gjykatat në raportin e monitorimit të realizimit të Planit do të paraqesin edhe vështirësitë dhe rekomandimet për përmirësim apo rishikim.

Anëtari përgjegjës për marrëdhënien me median dhe publikun pranë KLGJ, do të raportojë çdo vit mbi ecurinë e zbatimit të Planit dhe do të koordinojë bashkërendimin e aktiviteteve përmes zhvillimit të takimeve periodike të pikave të kontaktit. Këto takime do të synojnë nxitjen e gjykatave për një qasje proaktive për marrëdhëniet me publikun dhe median, shmangien e mbivendosjes së aktiviteteve dhe prodhimit të materialeve informuese mes gjykatave, si dhe sigurimin e një lidhje harmonike të këtij Plani Komunikimi me politikat strategjike që ka Këshilli për sa i përket komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun.

Vlerësimi i impaktit të Planit të Komunikimit, gjatë zbatimit të tij dhe në fund, do të mbështetet në indikatorët e performancës dhe të impaktit të parashikuar për çdo objektiv. Indikatorët mund të përditësohen në vijimësi në varësi të zhvillimeve që mund të ndodhin në sistemin gjyqësor.